

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Pyjet”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm dhe transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Projektligji përaftron: - Rregulloren e Këshillit (KE) nr.2173/2005, 20 dhjetor 2005, “Për ngritjen e një skeme licencimi FLEGT për importin e drurit në Komunitetin Evropian” CELEX_32005R2173, OJ L 347, 30.12.2005, p. 1-6 ; - Rregulloren (BE) nr.995/2010, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 20 tetor 2010, që përcakton detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin dru/lëndë druri dhe produkte druri në treg, CELEX_32010R0995, OJ L 295, 12.11.2010, p. 23-34.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr. 814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Pyjet në Shqipëri, 2019–2030”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	24.05.2019 dhe Tetor 2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Nëntor 2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	3.12.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MTM- Nr. 00
TE DHËNA KONTAKTI (emri, e-mail, numri i telefonit të personit të kontaktit)	Klodiana Marika e-mail-i: klodiana.marika@turizmi.gov.al numri i telefonit: 0692092872
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Sektori i pyjeve në Shqipëri ka rol të rëndësishëm mbrojtës në ruajtjen e natyrës dhe rol prodhues në rritjen ekonomike të vendit, nëpërmjet zhvillimit industrial, punësimit në zonat rurale, si dhe funksione të tjera. Manaxhimi i pyjeve aktualisht bëhet nga 61 bashkitë, përveç rreth 15% të fondit pyjor që janë Zona të Mbrojtura dhe manaxhohen nga AKZM. Nga takimet me aktorët kryesorë rezulton një pasqyrë e realitetit ekzistues të sektorit sipas drejtimeve kryesore. Problematikat kryesore me të cilat përballen sektori i pyjeve lidhen me degradimin e vazhdueshëm të fondit pyjor kombëtar, mungesën e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, shkallën e lartë të informalitetit që ekziston në sektorin pyjor, shfrytëzimin dhe tregtimin e lëndës drusore, financimin e	

pamjaftueshëm, mungesën e informacionit dhe kapaciteteve teknike dhe njerezore, tendenca mbishfrytëzimi dhe nënvlerë të produkteve jodrusore, investime të pakta në infrastrukturë dhe shërbime mirëmbajtjeje, etj.

Situata ekzistuese e sektorit të pyjeve paraqitet e vështirë, pasi sektori i pyjeve ka qenë vazhdimisht objekt ndryshimesh shumë të shpeshta (edhe si rezultat i reformave të ndryshme qeverisëse, si ajo territoriale, decentralizimi, institucionale, etj.). Nuk ka patur një Dokument Politikash, vetëm Strategjia (jo e mirëfilltë) e 2004 me kontekstin e 15 viteve më parë, e cila është hartuar përpara përfundimit të inventarizimit (pra bazuar në të dhëna jo të përditësuara). Ndërkohë që aktualisht nuk ka asnjë plan mbarështimi nga 364 ekonomi pyjore, çka evidenton mungesën e një strategjie të qëndrueshme dhe të një analize të mirëfilltë të këtij sektori, por edhe nevojën për një reformim të thellë dhe afatgjatë.

Analiza mbi Politikën, Strategjitë dhe Programet e zhvillimit të sektorit nxjerr **në pah trendin negativ të zhvillimit të pyjeve, me nevojë urgjente frenimin e degradimit për të sjellë zhvillimin në kahun e duhur.** Gjithashtu vihet re mungesa e strategjive të mirëfillta të sektorit të bazuara në analizë të thelluar e reale të situatës në terren, mungesën e Planit Kombëtar sektorial. Planet e mbarështimit mungojnë ose iu ka mbaruar afati i veprimit, kurse projektet e zhvillimit janë të paktë ose jofizibël për shkak trajtimi të copëzuar apo të paintegruar.

Volumi i pyjeve ka rënie alarmante (*ku vetëm gjatë 2006-2017 ka rënë me 32%*), duke rezultuar aktualisht me një volum të fondit pyjor prej rreth 55 milion m³. Një ndër problematikat kryesore që haset është *Shfrytëzimi i paqëndrueshëm, duke marrë prej pyjeve më shumë nga ç'mund të prodhohet prej tyre.*

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor kombëtar
- Përmirësimi dhe forcimi i detyrimeve që lidhen me mbrojtjen e fondit pyjor në Shqipëri;
- Përcaktimi i organeve në nivel lokal/vendor, që do të ngarkohen për menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e fondit pyjor në vend;
- Ndarja e qartë e përgjegjësi midis organeve që do të ngarkohen me menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e fondit pyjor dhe kullësor si: Ministrisë përgjegjëse për Pyjet, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura e degëve rajonale të saj që menaxhojnë, si dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Pushtetit Vendor (bashkitë).
- Përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të Fondit pyjor nga pushteti vendor.
- Kthimin e sektorit pyjor në efikasitet të plotë

Si rezultat, në fund të këtij procesi, objektivat kryesore, në mënyrë të përbledhur, që synohen të arrihen janë:

- Rregullimi i qartë dhe i plotë i të drejtave dhe detyrimeve të aktorëve;
- Riorganizimi funksional i sektorit (nga ministria deri në komunitetet vendore);
- Ekuilibrimi i përdorimit të pyjeve për energji dhe industri duke ballancuar rritjen e pyjeve me përdorimin e tyre;
- Mbrojtja e pyjeve (nga zjarri, prerjet e paligjshme dhe dëmtuesit natyrorë) dhe zvogëlimi i shkallës së informalitetit në përdorimin e produkteve pyjore deri në masën 5%.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave, janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- **Opsioni 0 (status quo):** nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo ligj të ri;
- **Opsioni 1:** ndryshim i ligjit ekzistues (*Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"*, i cili është ndryshuar 7 herë);
- **Opsioni 2:** Hartimi/miratimi i ligjit të ri kuadër "Për Pyjet".

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar, do të përfshijnë kosto të drejtëpërdrejta për buxhetin e shtetit, por të cilat janë parashikuar në PBA 2020-2022 si pjesë e programit të administrimit të pyjeve, si dhe nga kostot minimale të lidhura kryesisht me procesin e ushtrimit të përgjegjësive funksionale në sektorin e pyjeve nga institucionet përgjegjëse për pyjet.

Konkretisht PBA 2020-2022, krahas buxhetimit për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit normal të institucioneve të sistemit ministror që kanë lidhje dhe ndërthuren me pyjet (të tillë si MTM, AKP, AKZM/AdZM, AKM, etj.), parashikon edhe zërat e mëposhtëm të planifikimit buxhetor afatmesëm si pjesë e programit për administrimin e pyjeve të MTM-së, që lidhen me disa produkte/projekte dhe me buxhetin e tyre përkatës të shtrirë në vite, duke nisur nga buxheti i vitit aktual 2019 e deri me projeksionin e viteve 2020, 2021 dhe 2022.

Kryesisht këto produkte dhe projekte i referohen hartimit të disa planeve të mbarështimit/manaxhimit për Zonat e Mbrojtura dhe për fondin pyjor publik për 4 bashki, ngritjes së sistemit të informacionit dixhital ALFIS (*dizenjimi, metodologjia, vënia në funksionim e programit dhe krijimi i një database të ri të kadastrës së fondit pyjor publik i lidhur me sistemin GIS, mbështetur nga Banka Botërore dhe SIDA*), regjistrimit të fondit pyjor (*vlerësimi i dokumentacionit ligjor dhe gjendjes për zonat e përcaktuara, përgatitja e hartës dixhitale dhe kartelës për sipërfaqet e regjistruara, integrimi i tyre dhe databazës së ish-ZRPP apo ASHK*), realizimit të raporteve të monitorimit në zonat e mbrojtura dhe planifikimit të menaxhimit, kostot për inventarizimin kombëtar të pyjeve, modelet hidrologjike dhe krijimi i mekanizmave të financimit për të zvogëluar degradimin e tokës, sistemit elektronik të monitorimit të pyjeve (*përmirësimi i cilësisë së shërbimit për parandalimin e kundërvajtjeve për prerjen e pyjeve*), ndërgjegjësimit publik, planit gjinor të veprimit, projekti i shërbimeve mjedisore (TVSH).

Gjithashtu është parashikuar kryerja e inspektimeve (*referuar subjekteve që ushtrojnë aktivitete në fondin pyjor, të klasifikuara si aktivitete me risk të lartë, për uljen e paligjshmërisë në aktivitetin ekonomik të tyre dhe kthimin në normalitet të ekuilibrave të prishur në pyje, dhe të marrjes së vlerave të tyre për plotësimin e nevojave ekonomike të shoqërisë*).

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur produktet për programin e administrimit të pyjeve me vlerat përkatëse sipas PBA 2020-2022 (në 000 lekë)

Produkte	Buxhet 2019	PBA 2020	PBA 2021	PBA 2022
Raporte monitorimi në fondin pyjor	251,000	249,000	249,000	249,000
Inspektime të kryera	178,580	199,000	206,000	207,000

Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve	8,640	8,600	8,600	
Plane menaxhimi për pyjet	-	40,088	150,000	158,600
Sisteme Informacioni dixhital (ALFIS)	39,816	-	-	-
Fondi pyjor dhe kullor i regjistruar	158,754	-	-	-
Plan gjinor i veprimit	32,548	-	-	-
Inventari kombëtar i fondit pyjor dhe kullor publik	12,357	-	-	
Modele hidrologjike	41,070	-	-	-
Plane mbarështimi për fondin pyjor dhe kullor	90,455	-	-	
Projekti i shërbimeve mjedisore	157,150	109,912		
Total	970,640	606,600	613,600	614,600

Realizueshmëria e projektligjit, krahas PBA 2020-2022, mundësohet edhe nga mbështetja e planifikuar nga Banka Botërore dhe SIDA, donatorë dhe sipërmarrës të tjerë. Ritheksojmë se Sida mbulon kostot për ligjin e ri, përfshirë regjistrimin fillestar të fondit pyjor financiar nga SIDA dhe Banka Botërore, ndërkohë që synohet që pyllëzimet të realizohen kryesisht nga sipërmarrjet (gjelbërimi specifik), OJF, dhe komunitetet. Ndërkohë që, miratimi i këtij projektligji brenda vitit 2019, do t'i hapte rrugë sigurimit të mbështetjes së mëtejshme financiare nga Banka Botërore për sektorin e pyjeve dhe disbursimit të mbështetjes buxhetore përkatëse prej saj, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sektorit dhe mbështetjen për procesin vijues të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për pyjet, për të mundësuar përgatitjen e tyre në një kohë më të shpejtë.

Opsioni i preferuar synon se pari qeverisjen e qendrueshme të fondit pyjor kombëtar, rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare, si dhe organizimin funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Vlerësohet se efektet që mund të lidhen me rishikimin/rishpërndarjen e duhur të funksioneve, do të kenë kosto minimale, pasi do të mbulohen nga buxheti i parashikuar i strukturave aktuale dhe burimet njerëzore që ato kanë në lidhje me pyjet (të tilla si MTM, AKP, AKZM, AKM, etj.), apo ato që lidhen me koordinimin me NjQV, përfshirë shfrytëzimin e kapaciteteve të emergjencave civile të Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëpunimin me MBZHR, MIE *(bëhen plotësisht të realizueshme ose shoqërohen me kosto minimale në qoftë se koordinohen me projektet aktuale në zbatim si programi “Mbajlljet 2020”, projektet e turizmit, programin “100 Fshatrat”, etj.)*.

Fakti që tashmë është miratuar ngritja, organizimi dhe funksionimi i AKP-së dhe është mbuluar buxheti përkatës për këtë qëllim, lehtëson zbatueshmërinë e opsioni të preferuar për fushën e pyjeve. Konkretisht, VKM-ja nr.570, datë 17.07.2019, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, përcakton se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe:

- nëpunësit civilë aktualë të strukturës përgjegjëse për pyjet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, transferohen në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve;
- numri i punonjësve dhe fondet buxhetore të strukturës përgjegjëse për pyjet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Pavarësisht se aktualisht të gjitha planeve të mbarështimit të 364 ekonomive pyjore iu ka kaluar afati dhe duhet konsideruar kosto e hartimit të tyre, vlen të evidentohet se kjo nuk është një situatë që buron nga miratimi i ligjit të ri, përkundrazi, kjo është një situatë e mbartur ndër vite dhe në dijeni të plotë të bashkive dhe institucioneve qendrore, duke u

planifikuar në buxhetet e tyre përkatëse vjetore apo afatmesme, si dhe si pjesë e projekteve me donatorë, për t'i dhënë një zgjidhje të qëndrueshme për të ardhmen. Për këtë qëllim, në Janar të 2019 është miratuar nga MTM edhe udhëzuesi “Manuali i Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, duke synuar mbështetjen për hartimin e tyre, bazuar në rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara, duke përfshirë të gjithë aktorët dhe duke siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë të aktorëve në procesin e hartimit të planit dhe planifikimit të masave.

Referuar ndikimit mbi buxhetet vendore të bashkive, strukturat përgjegjëse për pyjet janë funksionale që pas transferimit në pronësi të bashkive të pyjeve publikë, si pjesë e reformës në vitin 2016 (miratuar me VKM nr.433, datë 08.06.2016). Edhe në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore për personelin me arsim profesional dhe të lartë pyjor, ky është një detyrim për strukturat përgjegjëse të pyjeve në bashki i përcaktuar që me ndryshimet e ligjit aktual (ligji nr.9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar), ku në maj 2016, me ligjin nr.48/2016, përcaktohej detyrimi për të ngritur strukturat e pyjeve sipas kriterëve përkatëse (ashtu siç janë edhe në këtë projektligj) me qëllim administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor brenda kufijve territorialë administrativë. Ndaj, me miratimin e opsionit të preferuar, duhen konsideruar kostot potenciale vetëm nëse pranë bashkive do të shtohen apo jo kapacitete në burime njerëzore pranë strukturave të kontrollit në pyje (por kjo është në varësi të situatës aktuale të çdo bashkie dhe strukturës ekzistuese përgjegjëse për pyjet). Ndërkohë, me qëllim uljen e kostove përkatëse, në këtë projekt ligj nuk janë vendosur përcaktimet në lidhje me uniformën e punonjësve të shërbimit pyjor (shenjave dalluese, armatimit dhe mjeteve të tjera), siç kanë qenë të përcaktuara më parë në ligjin aktual nr.9385, datë 04.05.2005.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik do të shoqërohen ndër vite me paraqitjen e kërkesave të reja dhe kostove të vazhdueshme për përmbushjen e përgjegjësisë në funksion të zbatimit të nevojave për pyjet në territorin e Republikës së Shqipërisë, por që janë brenda kufijve të planifikimit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe mbështetjes së donatorëve. Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike* të mundshme, si pasojë e administrimit më të mirë të sektorit dhe fondit pyjor kombëtar, tashmë edhe me rolin e AKP në sektor si hallka e munguar ndërmjet Ministrisë dhe 61 bashkive. Po kështu do të shfrytëzohet pozitivisht përfitimi që njerëzit marrin prej shërbimeve të ekosistemit dhe që sigurohen nga funksionet natyrore të pyjeve, përfshirë edhe rritjen e turistëve dhe vizitorëve në FPK, që potencialisht shoqërohen me pagimin e tarifave në zonat përkatëse, apo me realizimin e veprimtarive të tjera të lejuara sipas ligjit. Per shkak të rritjes së zbatimit të ligjshmerisë, krijimit dhe funksionimit të AKP, rritjes së bashkepunimit nderinstitucional, ndarjes me të mirë të rolit, detyrave dhe përgjegjësisë etj. do të zvogelohet edhe shkalla e informalitetit në pyje, duke sjelle me shume të ardhura në sektorin publik, dhe duke e kthyer këtë sektor në efikasitet të plotë.

Nga vlerësimi i mësipërm, evidentohet opsioni i preferuar nuk do të sjellë impakt të konsiderueshëm në shpenzimet buxhetore të shtetit. Ndërkohë që me rregullimin e ri ligjor, synohet administrimi më i mirë i sektorit dhe fondit pyjor kombëtar, duke pasur si pritshmëri për të ardhmen mundësimin e efekteve financiare pozitive në sektor.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë kryesor është një mjedis me i pastër, me i shëndetshëm, me pak erozion dhe rreshqitje të tokës, zbutje të pasojave të permbytjeve etj. Nga ana tjetër kemi kontributin në mbrojtjen e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky opsion synon ruajtjen, shtimin e sipërfaqes pyjore dhe rritjen e volumit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar (FPK), shfrytëzimin dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të burimeve

pyjore *përkundrejt* mundësisë që pyjet kanë, pa cënuar vazhdueshmërinë e jetës dhe ciklin e pyllit, si dhe garantimin e shërbimeve cilësore duke synuar mbrojtjen e duhur, përmirësimin dhe rigjenerimin e hapësirës pyjore. Politikat e reja në pyje, gjithashtu mund të sjellë edhe disa *ndikime mjedisore jo të drejtpërdrejta*, duke përfshirë krijimin e mundësive për ndërveprimin me zhvillimin e eko-turizmit, agropylltarisë, infrastruktura me te qendrueshme etj. Ndërkohë që, duke përbërë 15% të FPK, zonat e mbrojtura dhe rregullimi i posaçëm i tyre vazhdon të garantojë një trajtim specifik për mbrojtjen e tyre nga organet/strukturat përgjegjëse për menaxhimin/monitorimin e tyre dhe sigurimin maksimal të vlerave mjedisore.

Ndikime sociale të drejtpërdrejta te komunitetet, lidhen me faktin që nëpërmjet politikave të reja referuar opsionit të preferuar, bëhet përforcimi i statusit të pyjeve si një pasuri me vlerë kombëtare si dhe ridimensionimi i rëndësisë dhe peshës së pyjeve në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Pyjet si pasuri e përbashkët, ku të drejtat dhe detyrimet, rregullohen në raport të drejtë mes përfitimit dhe detyrimeve, të shoqërisë në tërësi, duke i dhënë prioritet zhvillimit rural, komuniteteve lokale dhe shtresave vulnerabël të shoqërisë (*opsioni i preferuar parashikon të drejtën e përdorimit të fondit pyjor dhe të gëzimit të fruteve që rrjedhin prej FPK, nga personat që u janë dhënë në përdorim pjesë të fondit pyjor, në masën që kanë nevojë për vete dhe për familjet e tyre. Familjeve dhe komuniteteve në zonat rurale u njihet e drejta e përdorimit të sipërfaqeve të fondit pyjor në afërsi të fshatit. Në kuadër të politikave sociale për zbutjen e varfërisë, shtrohet opsioni i dhënies të së drejtës së shitjes së materialit drusor të vjelë nga fondi pyjor për familjet në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike*). Ky opsion gjithashtu adreson disa çështje me karakter gjinor, duke synuar fuqizimin e rolit të gruas në përputhje me parimin e barazisë gjinore (*gratë përbëjnë një forcë të konsiderueshme pune dhe janë kontribuese të rëndësishme në zonat rurale, por ato pozicionohen në nivelin më të ulët përsa i takon prosperitetit ekonomik, pjesëmarrjes dhe proceseve vendim marrëse, kjo për shkak të pabarazisë gjinore që shoqërohet me një kosto të lartë ekonomike për vendin*). Ndaj, politika synon të krijojë mbështetjen shumë dimensionale për të garantuar barazinë gjinore përmes sigurimit të një qasje të barabartë, sigurimit të të drejtave të barabarta dhe eliminimit të formave të ndërvlerësive. Konkretisht, qëllimi kryesor i opsionit të preferuar është zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të pyjeve, që kontribuon për një jetë më të mirë, për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes, duke rregulluar marrëdhëniet në sektorin e pyjeve, që kanë ndikim thelbësor në cilësinë e mjedisit natyror, në zhvillimin e bujqësisë, energjisë dhe turizmit, në uljen e varfërisë, zhvendosjen e popullsisë, zbutjen e konflikteve dhe pabarazive me bazë sociale, gjinore, si dhe në sigurinë e vendit.

Konkretisht ky opsion bën përcaktime në lidhje me respektimin e parimit të barazisë gjinore në disa aspekte: tek e drejta e përdorimit të fondit pyjor kombëtar për nevojat e komuniteteve rurale, në përputhje me politikat për zhvillimin rural, duke njohur përgjegjësitë për ruajtjen dhe kujdesin ndaj pyllit; tek garantimi i koordinimit, bashkëveprimit dhe angazhimit të strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qëndror dhe vendor si dhe të aktorëve të tjerë (ojf, biznese, komunitete, etj.); tek mbështetja teknike që ofron struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki nëpërmjet këshillimit dhe organizimit të trajnimeve të pronarëve privatë dhe të përdoruesve të pyjeve publikë dhe organizatave të tyre; gjatë ngritjes së strukturave bashkiake përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre; apo tek veprimtaritë kërkimore e shkencore në fushën e pyjeve që kryhen nga institucione arsimore e shkencore, subjekte juridikë e fizikë, që përmbushin kushtet dhe kriteret, sipas legjislacionit të posaçëm në fushën kërkimore-shkencore, duke konsideruar edhe respektimin e barazisë gjinore.

Formalizimi i plote i sektorit pyjor do sigurojë me shume te ardhura ne financat publike, duke u rikthyer keshtu ne formen e investimeve per komunitetet qe jetojne ne zonat rurale. *Ndikime sociale indirekte*, i referohen edhe uljes së paligjshmërisë në pyje dhe rritjen e parametrave të rendit dhe sigurisë publike në fondin pyjor kombëtar. Në këtë kuadër, përcaktimi i detyrimeve konkrete për çdo institucion pjesë e qeverisjes së sektorit të

pyjeve, në nivel qëndror apo vendor, përfshirë edhe grupet e interesit, qartësimi i funksioneve të tyre, në veçanti i strukturave përgjegjëse për pyjet në bashki/ZM dhe forcimi i rolit të strukturave komunitare pranë bashkive, do të ndikojë në parandalimin e rasteve abuzive, zjarreve, por edhe të veprave penale që mund të kryhen në FPK.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i perzgjedhur në këtë dokument është **Opsioni 2**, Hartimi/miratimi i ligjit të ri kuadër “Për Pyjet”.

Ky opsion është perzgjedhur, pasi garanton qeverisjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar duke dhënë një kuadër të plotë të të gjithë praktikës menaxhuese, kontrolluese dhe monitoruese si dhe duke përcaktuar në mënyrë të qartë strukturat perkatese përgjegjëse për pyjet. Nga ana tjetër ky opsion synon një përafrim maksimal të legjislacionit të BE-së në sektorin pyjor, duke përbërë kështu një bazë të qëndrueshme për legjislacionin kombëtar.

Me mbështetjen e qeverisë suedeze “Mbi kuadrin rregullator të sektorit të pyjeve”, është bërë një analizë paraprake ligjore dhe e problematikave të sektorit, prej së cilës rezultoi nevoja për të hartuar dhe miratuar një Dokument të Politikave për Pyjet, i cili të pasohet me pas nga Ligji i ri sektorial për Pyjet;

Bazuar në situatën ku gjendet sot sektori pyjor, rezulton se ligji aktual apo opsioni për ndryshimin e tij, aktualisht nuk mundëson zbatimin e plotë të politikave të reja për pyjet në Shqipëri për periudhën 2019-2030, ndaj kjo paraqet nevojën e miratimit të një ligji të ri. Kjo edhe pasi dispozitat që do të prekeshin janë të shumta (mbi 50%) dhe rrjedhimisht për efekt të teknikës legjislative, zgjidhet ky opsion - Hartimi/miratimi i ligjit të ri kuadër “Për Pyjet”.

Për më tepër që me ligjin aktual sektori shfaqet me shumë problematika dhe trend negativ të gjendjes së pyjeve dhe Fondit Pyjor Kombëtar për të ardhmen. Ndaj një rishikim i ligjit aktual për herë të tretë nuk ka gjasa që të sjellë përmirësim të gjendjes në cilindo aspekt të sektorit të pyjeve, por perkundrazi një vazhdim të përkeqësimit të situatës dhe degradimit të fondit pyjor sic ka ndodhur tashmë gjatë gjithë periudhës së funksionimit të ligjit aktual. Nga ana tjetër garantimi i kuptueshmërisë, qartësisë, harmonizimit dhe logjikës juridike të dispozitave, adreson domosdoshmërisht nevojën e hartimit të një ligji të ri. Kjo edhe sepse ligji aktual nuk adreson apo rregullon në mënyrën e duhur çështjet dhe problematikat aktuale me të cilat përballen sot sektori pyjor.

Hartimi/miratimi i ligjit të ri kuadër “Për Pyjet” është një nevojë edhe për shkak të përcaktimit të rolit dhe përgjegjësisë funksionale për të gjithë institucionet përgjegjëse për pyjet, në nivel qëndror dhe vendor, tashmë edhe me ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Pyjet mund të bëhet vetëm me ligjin e ri.

Ligji i ri për pyjet ofron një mundësi edhe me të mirë për përafrimin e dy rregullores për shitjen e lëndës drusore dhe produkteve të tij në tregun e BE (konkretisht Rregulloren e Këshillit/KE nr.2173/2005, 20 dhjetor 2005, “Për ngritjen e një skeme licencimi FLEGT për importin e drurit në Komunitetin Evropian” dhe Rregulloren BE nr.995/2010, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 20 tetor 2010, që përcakton detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin dru/lëndë druri dhe produkte druri në treg), rregullat dhe procedurat për zbatimin e të cilave do të detajohen me akt nënligjor pas miratimit të ligjit.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në 000 lekë):

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
606,600	613,600	614,600

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me konsulentët kombëtare dhe ekspertët ndërkombëtare, ka kryer takime teknike konsultative të grupit të punës dhe rezultoi nevoja për të hartuar dhe miratuar një Dokument të Politikave për Pyjet, i cili të pasohet nga Ligji i ri sektorial për Pyjet;

Pas miratimit të Dokumentit të Politikave për Pyjet 2019-2030, Projektligji vjen si propozim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ai është hartuar nga një Grup Punë ministror dhe ka kaluar në një proces të gjerë diskutimesh dhe konsultimi me një sërë takimesh të veçanta me aktorët e sektorit, duke nisur nga tremujori i fundit i vitit të kaluar. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar edhe konsultimet e realizuara në kuadër të projektit për reformën rregullatore në pyje (me komponent dokumentin e politikave për pyjet dhe projektligjin e ri sektorial), duke përfshirë **4 seminare rajonale në Shkodër, Korçë, Kukës, Fier dhe takimin final në Tiranë në Dhjetor 2018**, prej të cilave u morën komentet dhe sugjerimet kryesore nga bashkitë dhe Administratat e Zonave të Mbrojtura në lidhje me rolin e tyre të ri dhe të fuqizuar për të përmirësuar situatën në pyje dhe veçanërisht efikasitetin e kontrollit dhe inspektimit, që tashmë propozohen të miratohen me këtë projektligj.

Gjithashtu, në lidhje me draftin e konsoliduar të projektligjit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka bërë një **dëgjese të hapur publike në datë 24.05.2019** me pjesëmarrjen e Ministrisë së Brendshme dhe grupet kryesore të interesit (të cilët ishin njohur paraprakisht me përmbajtjen e projektligjit të ri për pyjet), duke përfshirë përfaqësues të bashkive, ofrues të ndryshme (*Federata Kombëtare dhe Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave, shoqata të përdoruesve të pyjeve në Shqipëri, shoqata e bimëve aromatike mjekësore dhe esencave të Shqipërisë, etj.*), si dhe profesionistëve më të spikatur të fushës, krahas përfaqësuesve të Ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë. Në këtë dëgjese publike u parashtrun disa mendime dhe sugjerime nga të pranishmit në lidhje me të gjitha nenet e projektligjit, për të cilat u ra parimisht dakort, të cilat konsistojnë në: aspekte të teknikës legislative lidhur me përkufizimet, çështje në lidhje me administrimin e sektorit të pyjeve dhe detajimin e mëtejshëm mbi të drejtat dhe detyrimet mbi pyjet (pronësia, roli i fshatit, etj.), mbi organizimin institucional dhe rolin e Agjencisë Kombëtare për Pyjet si dhe idenë e një forumi për pyjet apo këshilli, por edhe çështje që lidhen me personelin pyjor, u diskutua mbi përfitimet nga produktet dhe shërbimet e fondit pyjor kombëtar. Gjithashtu u diskutua mbi dispozitat që lidhen me zbatueshmërinë e ligjit të ri dhe çdo të ndodhte me moratoriumin në pyje.

Në vijim të dëgjesës publike, grupi i punës përfshiu në rishikimin e projektligjit edhe ekspertë të jashtëm të fushës së pyjeve prezent në dëgjesën publike, bashkë me të cilët bëri adresimin e duhur të të gjitha komenteve në muajt në vijim, duke u mbledhur në një sërë takimesh teknike konsultative të grupit të punës në ambjentet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Kështu, gjatë periudhës **Maj – Shtator 2019**, projektligji i është nënshtruar disa rishikimeve mbështetur në komentet dhe sugjerimet e aktorëve dhe ekspertëve të ndryshëm, përfshirë ekspertët ndërkombëtarë të Bankës Botërore dhe SIDA-s, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe formës së projektaktit.

I gjithë procesi i draftimit dhe konsultimit u mbështet nga Connecting Natural Values and People (CNVP) Albania dhe bashkëpunëtorët e saj nëpër Shqipëri, si dhe me rolin specifik të konsulentëve të angazhuar për këtë projekt: “Magnum Opus Group” sh.p.k. (MOG), bashkë me Ekspertin e Pyjeve, Ekspertin për Barazinë Gjinore dhe Lehtësimin e Varfërisë, si dhe Ekspertin Ligjor. Gjithashtu sugjerime janë dhënë edhe nga ekspertët ndërkombëtarë të SIDA-s dhe Bankës Botërore, duke ofruar në mënyrë të vazhdueshme njohuri dhe ekspertizë bashkëkohore në fushën e pyjeve, të mjedisit, por edhe mbi barazinë gjinore dhe lehtësimin e varfërisë, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së projektligjit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe përafrimin e përcaktimeve të legjislationit

sektorial për pyjet me atë të BE. Në përfundim të këtij procesi të gjatë konsultativ, grupi i punës ka përcjellë brenda Minsitrisë së Turizmit dhe Mjedisit draft ligjin final për pyjet. Sa më sipër, projektakti është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me institucionet/agjencitë e varësisë së këtij sistemi ministror, mbështetur në kontributin e ofruar nga inxhinierë pyjesh & teknikienë, por edhe me propozimet/sugjerimet e marra nga bashkitë dhe komunitetet vendore që në fazën e hartimit të Dokumentit të Politikave dhe në vijim, nëpërmjet adresimit aty të çështjeve që duhej të gjenin zgjidhje në ligjin e ri për pyjet, gjithashtu edhe të OJF-ve e shoqatave të përdoruesve, sipërmarrjeve private, duke përfutur nga asistencë e posaçme për këtë projekt nga mbështetja financiare suedeze SIDA dhe bashkëpunimi me Bankën Botërore.

Projektligji është publikuar në **Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike** me qëllim garantimin e përfshirjes në procesin e konsultimit të të gjithë aktorëve të interesuar. Konkretisht, më datë **22.10.2019** projektligji “Për Pyjet”, , janë publikuar për konsultim publik në Regjistrin elektronik të Konsultimit Publik në **website**:

- <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/> si dhe
- <http://www.mjedisi.gov.al/konsultime-me-publikun/>

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit për Pyjet, si dhe zbatimi i tij do të plotësohet dhe do të bëhet më i mundur me miratimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji.

Në zbatimin e këtij projektligji përfshihen disa institucione shtetërore, të cilët ngarkohen si vijon:

- Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore;
- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe strukturat përgjegjëse për pyjet në Ministri (për përgatitje dhe miratimin e të gjitha akteve nënligjore nën përgjegjësinë tyre por edhe ushtrimin e funksioneve sipas ligjit);
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë (për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore të përbashkëta);
- Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore të përbashkëta);
- AKP (sipas rolit dhe përgjegjësi ligjore);
- AKZM/AdZM (sipas rolit dhe përgjegjësi ligjore);
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore/strukturat e tyre (sipas rolit dhe përgjegjësi ligjore);
- grupet e interesit (sipas rolit dhe angazhimit që parashikohet në projektligj), etj.

Ndërkohë, projektligji përcakton se, strukturat, organet dhe institucionet ekzistuese në sektorin e pyjeve, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në ngritjen/riorganizimin e strukturave, organeve dhe institucioneve të reja sipas përcaktimeve dhe afateve të këtij projektligji.

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit “Për Pyjet”, si dhe zbatimi i tij do të plotësohet dhe do të bëhet më i mundur me miratimin e akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji, duke përbërë një instrument tjetër zbatues të politikës. Por, për të mos krijuar vakum, aktet nënligjore të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij projektligji dhe për aq sa nuk bien ndesh me të, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore.

Gjithashtu, Banka Botërore dhe SIDA që në misionin e tyre kanë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe pyjet, do të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin dhe monitorimin e kësaj politike dhe përcaktimeve të projektligjit, duke qenë

njëkohësisht financues/mbështetës të projektit të reformës rregullatore në pyje (pjesë e të cilit ishte hartimi/miratimi i Dokumentit të Politikave për Pyjet 2019-2030 si dhe projektligji i ri për Pyjet), por edhe duke pasur pritshmëri për të ardhmen e pyjeve në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes për projekte të së ardhmes në sektor dhe disbursimit të fondeve përkatëse për këtë qëllim.

AKP, brenda 12 muajve nga fillimi i veprimtarisë së saj, realizon miratimet, harton standardet, specifikimet, rregullat, lejimet dhe ushtron detyrat e parashikuara në këtë projektligj. Në funksion të ngritjes në rang kombëtar të një sistemi të integruar të planifikim-zhvillimit të fondit pyjor kombëtar, Agjensia Kombetare e Pyjeve do të kryejë analizën e dokumenteve ekzistuese, vlerësimin e dokumenteve të planifikimit që janë të nevojshme për të gjithë fondin pyjor kombëtar, dhe përlogaritjen e kostove dhe afateve të nevojshme për hartimin e tyre.

Projektligji përcakton se, funksioni i kontrollit garanton ekzekutimin optimal të veprimtarive në fondin pyjor kombëtar, në përputhje me dokumentet planifikues në pyje, normat dhe standardet e miratuara, përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi, kushtet e lejeve, licencave apo kontratave të nënshkruara mes strukturave përgjegjëse për pyjet dhe subjekteve përkatës. Kontrolli ushtrohet mbi veprimtaritë e shfrytëzimit dhe të shërbimeve në pyje që realizohen nga strukturat përgjegjëse për pyjet dhe/ose nga subjektet përkatës, duke kontrolluar të gjithë ciklin që nga akordimi i lejeve dhe inputet e përdorura, proceset e ndjekura në kryerjen e këtyre veprimtarive, cilësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat (konformitetin) të rezultateve të arritura si dhe aktivitetet përmbyllëse rehabilituese sipas ligjit. Funksioni i kontrollit ushtrohet nga strukturat përkatëse në bashki dhe në zonat e mbrojtura, të cilat ushtrojnë detyrat e detajuara në projektligj në Kreun VII të projektligjit mbi kontrollin dhe kundërvajtjet në sektorin e pyjeve. Për këtë qëllim, ngarkohen organet e bashkive që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përcaktojnë dhe miratojnë ngritjen/riorganizimin e strukturave përgjegjëse për pyjet, ku përfshihen edhe ato kontrolluese, sipas përcaktimeve në këtë projektligj dhe aktet nënligjore në zbatim. Ndërsa Agjensia Kombetare e Pyjeve, në kuadër të garantimit të funksionalitetit të sistemit të kontrollit, orienton dhe mbikëqyr strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, duke ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mosushttrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Deri në vitin 1990, pavarësisht nga forcimi i sektorit, shteti, nëpërmjet një sistemi triskëtimi, garantonte vetëm furnizimin e familjeve në qytete me dru zjarri, çka tregon se “*de facto*” banorët e fshatrave vazhdonin të gëzonin të drejtën e përdorimit të pyjeve bazuar në traditën. Në vitin 1985 përfundoi inventarizimi i tretë kombëtar i pyjeve, ku fondi pyjor zinte gjithsej 1,048 mijë ha (*prej të cilëve 885 mijë ha pyje prodhues dhe 163 mijë ha pyje mbrojtës*), ndërsa vëllimi total 85,326,000 m³. Ky inventarizim vlerësoi se prerjet ishin mbi 2 herë më të mëdha se rritja vjetore e pyjeve, ndërsa në vitin 1988 përfundoi Inventarizimi Kombëtar i Bimëve Mjekësore, Tanifere e Eterovajore, që përcaktoi rezervat e mundshme për shfrytëzim. **Viti 1992** u shoqërua me ndryshime rrënjësore për sektorin e pyjeve, duke filluar me riorganizimin e institucionit qendror dhe me ligjin e ri të pyjeve në 1992. Për shkak të vështirësive që po përballej e gjithë ekonomia dhe faktit që subjektet private të krijuar rishtas, në shumë aspekte ishin të papërgatitur për të kryer aktivitetin në nivelet e ndërmarrjeve shtetërore, shfrytëzimi i pyjeve u ul krahasuar me periudhën e mëparshme. Administrimi dhe

mbrojtja e fondit pyjor shtetëror e komunal ishte përgjegjësi e Drejtorise se Pergjithshme te Pyjeve, nëpërmjet drejtorive të shërbimit pyjor, të cilat zëvendësuan ndërmarrjet pyjore. Në kuadrin e Drejtorisë u organizua edhe Policia e Shërbimit Pyjor.

Ligji riktheu të drejtën e dhënies së pyjeve të shtetit në përdorim të përbashkët të fshatit, të disa fshatrave ose komunës. Po ashtu, familjeve me banim të përhershëm në fshat, u njihte të drejtën të kishin në përdorim pjesë nga pylli komunal, me sipërfaqe nga 0.4 deri në 1.0 ha për familje.

Në periudhën 1994–2005 u hodhën bazat për decentralizimin e qeverisjes së pyjeve dhe transferimin e tyre në përdorim të komunave. Në këtë periudhë procesi u shtri në 138 komuna të vendit nëpërmjet hartimit me pjesëmarrje të planeve të mbarështimit të pyjeve komunale për 450,000 ha të transferuara në përdorim të pushtetit lokal. Në vitin 2004 u krye inventarizimi kombëtar i pyjeve. Fuqia e përgjithshme lëndore rezultoi rreth 74 milionë m³ lëndë drusore në këmbë.

Zgjidhja e problemeve të lindura gjatë një periudhe mbi 12 vjeçare, si dhe arritja e synimeve të reja, që i ishin shtruar sektorit të pyjeve, nuk mund të realizoheshin në kuadrin e ligjit ekzistues, prandaj, në 2005 u miratua ligji i ri i pyjeve. Në shtator 2005, sektori i pyjeve kaloi në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe në janar të vitit 2006, DPSHP shkrihet si institucion i pavarur. Në periudhën 2007-2014 sektorët që mbulonin pyjet në ministri u ristrukturuan disa herë, duke u shoqëruar me uljen e peshës së tyre dhe me zvogëlimin e numrit të punonjësve. Por, zhvillimi më i rëndësishëm, ishte decentralizimi i administrimit të fondit pyjor, si pjesë e reformës administrative të vitit 2014. Aktualisht janë 61 bashki, që kanë marrë në pronësi pyje dhe kullota publike, ndërkohë që 15% e fondit pyjor është përfshirë si zonë e mbrojtur nën AKZM.

Reformat e vazhdueshme të administratës pyjore u shoqëruan me dëme të pallogaritshme të fondit pyjor shtetëror. Boshllëku i krijuar nga mosplotësimi i nevojave energjetike të popullsisë u shoqërua me kërkesat e larta për dru zjarri, çka bëri të lulëzonte aktiviteti i prerjeve të paligjshme, që bëheshin jashtë çdo kriteri teknik duke kompromentuar të ardhmen e pyllit. Shpesh herë sipërfaqeve të prera në mënyrë të paligjshme u vihej zjarri për të zhdukur gjurmët e krimit pyjor. Ndaj në janar 2016 u miratua Moratoriumi i Pyjeve, për të frenuar situatën

- *Jepni kontekstin e politikës*

Prej vitesh pyjet po perjetojnë një proces degradimi të vazhdueshëm dhe në masë të frikshme. Për një periudhë rreth 10 vjeçare fondi pyjor kombëtar është pakesuar me 32% të volumit të tij, duke cenuar edhe sigurinë kombëtare të vendit. Kjo për shkak të kuadrit ligjor të pamjaftueshëm, mungesës së financimeve dhe së strukturave menaxhuese, shkallës së lartë të informalitetit që ka ekzistuar në sektorin pyjor, prejreve dhe zjarreve masive në pyje, paqartësisë në rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme, reformave të ndërmarra në vend etj.

Pikerisht për arsyet e përmendura më sipër, krahasuar me fqinjët dhe rajonin, duke iu referuar volumit mesatar në m³/ha (sipas raportimeve kombëtare për "State of Europe's Forests 2015"), rezulton se Shqipëria renditet në fund të tyre sa i përket burimeve pyjore, si një vend me volum shumë të varfër në pyje. Planet e mbarështimit mungojnë ose iu ka mbaruar me 3 herë afati i vlefshmerisë së tyre (aktualisht nuk ka asnjë plan mbarështimi nga 364 ekonomitë pyjore), kurse projektet e zhvillimit janë të paktë ose jofizibël për shkak të trajtimit të copëzuar apo të paintegruar. Kuadri ligjor në fuqi përbëhet nga rreth 30 akte ligjore e nënligjore, ku ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor ka pësuar 7 ndryshime që nga momenti i miratimit në 2005, duke shkaktuar edhe pasiguri juridike. Është bërë decentralizimi i qeverisjes së pyjeve, ku aktualisht janë 61 bashki që kanë marrë në pronësi të gjithë fondin pyjor dhe kulloror në

pronesi publike, ndërkohë që 15% e fondit pyjor është përfshirë si zonë e mbrojtur nën Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Në janar 2016 u miratua Moratoriumi i Pyjeve, për të frenuar situatën e shkatërrimit të pyjeve.

Per shkak të gjendjes së vështirë që po përjetojnë pyjet, edhe në progres raportet e fundit të BE-së për Shqipërinë theksohet: ...'duhet të garantohet zbatimi i ligjit në rastin e prerjes dhe demtimit të pyjeve duke ndeshkruar shkelesit e ligjit...', si dhe ...'Duhet bërë përpjekje në lidhje me emetimet e gazeve sërre nga përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës, dhe pyjet. Për këtë kërkohej forcim i konsiderueshëm i kapaciteteve administrative, nevojitet shpërndarja e burimeve të nevojshme financiare, si dhe duhet zhvilluar më tej aktivitetet e ndërgjegjesimit publik.

Ndaj, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e SIDA në kuadër të projektit "Mbi kuadrin rregullator të sektorit të pyjeve", ka bërë një analizë paraprake ligjore dhe e problematikave të sektorit, prej së cilës rezultoi nevoja për të hartuar dhe miratuar një Dokument të Politikave për Pyjet, i cili të pasohet nga Ligji i ri sektorial për Pyjet;

Gjithashtu, Banka Botërore dhe SIDA që në misionin e tyre kanë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe pyjet, kanë qenë financues/mbështetës të projektit të reformës rregullatore në pyje (pjesë e të cilit ishte hartimi/miratimi i Dokumentit të Politikave për Pyjet 2019-2030 si dhe projektligji i ri për Pyjet).

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Pyjet si një pasuri kombëtare kanë pësuar një degradim dramatik në 10-15 vitet e fundit, ku për një periudhë kohore kaq të shkurtër fondi pyjor publik është pakesuar me 32% të tij. Problemi lidhet me degradimin e vazhdueshëm dhe kërcënimin që i kanoset fondit pyjor kombëtar si pasojë e mos financimit, mungesës së koordinimit ndërinstitucional dhe nivelit të ulët të sistemit të monitorimit, pamundësisë së ruajtjes, përmirësimit dhe rigjenerimit të burimeve pyjore të vendit.

Pavarësisht përmirësimeve që ka sjellë zbatimi i moratoriumit në pyje, prapë Shqipëria përballë me humbje të mëdha të fondit pyjor kombëtar për shkak të prerjeve dhe zjarreve në pyje si dhe nivelit të lartë që ekziston në fondin pyjor publik.

Shkaqet kryesore të këtij problemi janë:

- Buxhet i ulët për financime në pyllëzime
- Mungesa në sistemet dhe pajisjet për mbrojtjen e pyjeve
- Mungesa financimesh në përmirësimin e fondit pyjor kombëtar
- Pamundësi në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe një shkallë shumë e lartë e informalitetit në këtë sektor;
- Nivel i lartë i përdorimit të druve të zjarrit në shkallë kombëtare
- Mbivendosje e fushave të përgjegjësisë midis institucioneve;

Problemi i humbjes së fondit pyjor është në nivel kombëtar, pra prek të gjithë sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë, kryesisht zonat malore, por edhe Zonat e Mbrojtura Mjedisore.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë: Qeveria (Bashki, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjensia Kombetare e Mjedisit, Agjensia Kombetare e Zonave të Mbrojtura, Biznesi i produkteve dhe nënprodukteve pyjore) / biznesi (eko-turizmi)/ shoqëria civile (shoqata për mbrojtjen e biodiversitetit, shkencëtarë)/ qytetarët (vizitorë, turistë) pra, grupet e interesit të prekura përfshijnë institucionet e varësisë së Ministrisë përgjegjëse për mjedisin / pyjet, Bashkitë dhe Organizatat joqeveritare mjedisore qendrore e vendore të specializuara në fushën e konservimit dhe monitorimit të pyjeve.

E gjithë problematika e evidentuar këtu, gjen vend dhe adresohet në mënyrën e duhur në ligjin e ri, duke i hapur rrugë një qeverisje të qendrueshme dhe efektive të fondit pyjor kombëtar. Konkretisht në ligjin e ri përcaktohen mënyra me të qarta roli, detyrat dhe përgjegjësitë institucionale, përcaktohen normat që qarta për personelin që do të punojë në sektorin pyjor, përafrohet legjislacioni i BE-së etj.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në përgjithësi, detyrimet kryesore ligjore të BE-së për mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve do të transpozohen në mënyrë efektive në legjislacionin shqiptar, krahasuar me nivelin aktual të transpozimit i cili është shumë i ulët. Megjithatë, janë identifikuar disa mungesa të rëndësishme dhe kuadri aktual ligjor mbetet i paqartë në lidhje me masat specifike ligjore për shkak të fragmentimit të rregullave ose përsëritjes dhe mbivendosjes së dispozitave përkatëse. Prandaj nuk është gjithmonë e qartë se cili është legjislacioni i zbatueshëm, gjithashtu edhe shumë aspekte të legjislacionit të BE-së nuk mbulohen.

Nga sa më sipër, vlerësohet se është i nevojshëm hartimi i ligjit të ri për pyjet, me qëllim:

- a) përmbushjen e rekomandimeve të BE-së, Bankes Botërore dhe SIDA për hartimin e politikave me të plota, bazuar në të dhëna konkrete dhe shkencore si dhe nisur nga gjendja aktuale dhe reale e sektorit pyjor;
- b) Zbatimin e rekomandimeve të progres raporteve të viteve të fundit të BE-së për Shqipërinë për të arritur përafrimin e plotë legjislativ në fushën e pyjeve dhe përmirësimin e politikave dhe zbatimin e ligjshmerisë në këtë sektor;
- c) Përcaktimin qartë të organeve përgjegjëse për menaxhimin, konservimin dhe monitorimin e pyjeve dhe kullotave dhe për të shmangur mbivendosjet në këtë proces, duke u përqasur me reformat e ndërmarra nga qeveria vitet e fundit, si reformën territoriale dhe reformën në fushën e pyjeve dhe kullotave.
- d) Të zbatohet normativat dhe praktikat e mira menaxhuese në sektorin e pyjeve me qëllim qeverisjen e qendrueshme të tyre

Kjo ndërhyrje lidhet ndër të tjera edhe me objektivin e qeverisë së Shqipërisë drejt përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me rregulloret/direktivat përkatëse të paraqitura në nivel kombëtar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.

Risia që projektligji synon të sjellë, duke i grupuar ato objektivat sipas 4 qëllimeve strategjike të përcaktuara në Dokumentin e Politikave Pyjore 2030, të cilat janë janë përmbledhur si vijon:

1. Duke iu referuar Qëllimit Strategjik 1 "Administrimi i mirë":

- Përkthen 12 drejtimet e politikave të periudhës së dokumentit të politikave 2019-2030 në rregulla dhe dispozita ligjore, të zbatuara përmes 40 masave konkrete. Disa nga këto politika dhe masa janë rregulluar në Ligjin e ri.
- Përafrimi i legjislationit të pyjeve të BE-së me *acquis communautaire*, përkatësisht me 2 Rregullore: Nr.2173 / 2005 krijimin e një skeme licencimi FLEGT për importin e drurit në Komunitetin Evropian; dhe Nr. 995/2010 për detyrimet e operatorëve që vendosin produkte druri / druri në treg. Ligji gjithashtu parashikon miratimin e VKM-ve zbatuese, të cilat do të përcaktojnë procedurat e hollësishme për këtë qëllim.
- Forcimi i statusit të pyjeve si pasuri kombëtare dhe rivendosja e rëndësisë dhe peshës së pyjeve në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit. Pyjet si një pronë e përbashkët, ku të drejtat dhe detyrimet rregullohen në një ekuilibër të drejtë midis përfitimit dhe detyrimeve të shoqërisë në tërësi, duke i dhënë përparësi zhvillimit rural, komuniteteve lokale dhe shtresave të cënueshme të shoqërisë. Ligji adreson gjithashtu disa çështje gjinore, duke synuar fuqizimin e rolit të grave në përputhje me parimin e barazisë gjinore.
- Rindërtoi sistemin e planifikimit dhe zhvillimit të pyjeve për integrimin dhe harmonizimin e tij, me një grup mjetesh të planifikimit.
- E drejta për të përdorur fondin pyjor dhe për të shijuar frutat që rrjedhin prej tij, nga persona që u jepet të përdorin një pjesë të fondit pyjor, në masën që u nevojiten atyre dhe familjeve të tyre. Familjeve dhe komuniteteve në zonat rurale u jepet e drejta për të përdorur zonat e fondeve pyjore afër fshatit. Në kontekstin e politikave sociale për të lehtësuar varfërinë, ngrihet ideja e dhënies së të drejtës për të shitur lëndë të korrur të drurit për familjet në nevojë për ndihmë ekonomike.
- Financimi i sektorit përcakton parimin që vlerat monetare ose të ardhurat e siguruar nga pyjet duhet të rivendosen ose ri-investohen për mbrojtjen dhe rigjenerimin e pyjeve. Projektligji hap rrugën për krijimin e një fondi të veçantë publik për pyjet, i cili është ri-investuar në pyje (ndërthurur me programe / projekte pyjore, etj.).

Duke iu referuar Qëllimit Strategjik 2 "Organizimi funksional":

- Riorganizimi i arkitekturës institucionale në sektorin e pyjeve (nga qyteti në fshat / të përdoruesit e pyjeve) dhe rishpërndarja e një numër funksionesh për të garantuar efektivitetin dhe efikasitetin e qeverisjes së pyjeve:
- Organizoni sistemin e njohjes së pyjeve në një mënyrë të integruar.

3. Duke iu referuar Qëllimit Strategjik 3 "Përdorimi i qëndrueshëm":

- Identifikimi dhe kategorizimi i përfitimeve nga Fondi Kombëtar i Pyjeve (FKP), duke synuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe në funksion të zhvillimit të vendit, balancimin e përdorimeve të ndryshme në vlerën maksimale që mund të marrim kundër pyjeve të mundshëm për të siguruar vazhdimësinë e jetës dhe ciklin e pyllit:
- Fillimi dhe përfshirja për herë të parë e përfitimeve të shërbimeve ekosisteme të ofruara nga pylli dhe trajtimi i një pjese të veçantë të ligjit, për të vazhduar me aktivitetet që mund të kryhen në FKP, produkte jo druri dhe materiale druri.
- **Rëndësi më të madhe u jepet produkteve pyjore jo drusore, bazuar në përfitimet e tyre, trajtimin si një burim të rëndësishëm të ardhurash dhe mundësitë e punësimit dhe zhvillimit për komunitetet rurale.**
- është paraparë një sistem efikas i certifikimit dhe kontrollit të cilësisë së produkteve, përfshirë drurët dhe produktet pyjore jo-drusore.
- Ri-kategorizimi i shkeljeve në FKP dhe rivendosja e masës e përshkallëzimit të gjobave dhe masave përkatëse kundër shkelësve, shoqëruar me masa të përshtatshme për pezullimin / bllokimin e veprimtarisë, heqjen e licencave, konfiskimin, etj. **Përfshirë këtu gjobën për punonjësit e institucionit në rast të shkeljeve / jo pajtueshmërinë me përgjegjësitë ligjore.**

4. Duke iu referuar Qëllimit Strategjik 4 "Shërbime cilësore":

- Ligji i kushton një kapitull të veçantë pyjeve / shërbimeve të fondeve pyjore cilësore, për t'u integruar në kohën dhe vendin e duhur, duke synuar rritjen e shpejtë, si dhe detajimin e rregullave për mbrojtjen e duhur, në cilësinë e kërkuar, përmirësimin e FKP përmes planet përkatëse, aktivitetet e kryera në lidhje me ndërmarrjen e masave parandaluese, monitorimin e situatës në pyje dhe identifikimin e dëmeve ose sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, dëmtimin e rimëkëmbjes dhe rigjenerimin e pjesëve të dëmtuara të fondit pyjor kombëtar.
- Qëllimi është aplikimi i pyllëzimeve kompensuese dhe rehabilitimi efektiv i zonave ku aktivitetet / aktivitetet kryhen nga subjekte të ndryshme, siç detajohen nga legjislacioni dytësor (duke i dhënë fund situatës aktuale të pyllëzimeve fiktive ose joefektive nga subjektet).
- Parimi i FKP jo-zvogëlues dhe zgjerues është sanksionuar, së bashku me detyrimin për të zëvendësuar zonat e hequra prej tij.

IMPAKTI EKONOMIK

Kostoja për qeverinë

- Përfitimi i qeverisë - Do të ketë të ardhura nga tarifa e licencës.
- Kostoja për bizneset - Kostoja e tarifës së licencës dhe kostoja administrative e aplikimit për licencë.
- Përfitimi i bizneseve - Për shembull, skema e licencimit do të eliminojë avantazhin e padrejtë që gëzojnë operatorët ilegalë në mënyrë që bizneset të përfitojnë nga rritja e tregtisë.
- Përfitim ekonomik më i gjerë (indirekt) - mund të ketë një rritje të mundshme të tregtisë së drurit si rezultat i eliminimit të tregtisë së paligjshme.

Ndikimet shoqërore

Synohet të ketë një ndikim në punësim si rezultat i ndryshimeve në vëllimin tregtar të industrive pyjore. Mund të ketë ndikime të mundshme tek njerëzit në varësi të pyjeve, punëtorët e pyjeve dhe grupet e tjera të ndjeshme shoqërore.

Ndikimet në mjedis

Do të ketë një ndikim pozitiv në mjedis (mbi biodiversitetin dhe jetën e egër) si rezultat i eliminimit të tregtisë së paligjshme të drurit, zbatimit të planeve të menaxhimit, rritjes së kontrollit nga vete njesite e veteqeverisjes vendore për ruajtjen, mbareshtimin e konservimin e pyjeve.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Kjo politikë e propozuar synon përmbushjen e objektivave të mëposhtme:

- Qeverisjen e qendrueshme të fondit pyjor kombëtar
- Përmirësimi dhe forcimi i detyrimeve që lidhen me mbrojtjen e fondit pyjor në Shqipëri;
- Përcaktimi i organeve në nivel lokal/vendor, që do të ngarkohen për menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e fondit pyjor në vend;
- Ndarja e qartë e përgjegjësisë midis organeve që do të ngarkohen me menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e fondit pyjor dhe kullësor si: Ministrisë përgjegjëse për Pyjet, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura e degëve rajonale të saj që menaxhojnë, si dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Pushtetit Vendor (bashkitë).
- Përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të Fondit pyjor nga pushteti vendor.

- Kthimin e sektorit pyjor ne eficence te plote

Si rezultat, në fund të këtij procesi, objektivat kryesore, ne menyre te permbledhur, qe synohen te arrihen jane:

- Rregullimi i qartë dhe i plotë i të drejtave dhe detyrimeve të aktorëve;
- Riorganizimi funksional i sektorit (nga ministria deri në komunitetet vendore);
- Ekuilibrimi i përdorimit të pyjeve për energji dhe industri duke ballancuar rritjen e pyjeve me përdorimin e tyre;
- Mbrojtja e pyjeve (nga zjarri, prerjet e paligjshme dhe dëmtuesit natyrorë) dhe zvogelimi i shkallës së informalitetit në përdorimin e produkteve pyjore deri në masën 5%.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Gjatë analizës që është kryer nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e SIDA dhe Bankes Botërore, janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

- Opsioni i status quo-së (0): Mbajtja e ligjit ekzistues për pyjet. Kjo situatë do të vazhdojë të përkeqesojë me tej degradimin e fondit pyjor publik sic ka ndodhur gjatë gjithë kohës së funksionimit të këtij ligji. Boshllëku ligjor dhe institucional dhe si pasojë moszbatimi i plotë i dispozitave të ligjit ekzistues për shkak të ndryshimeve dhe reformave të zbatuara vitet e fundit, nuk do të ketë ndarje të qarta të përgjegjësisë dhe kompetencave për menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e fondit pyjor dhe kullësor;
- Opsioni 1: ndryshimi i ligjit ekzistues. Është konsideruar edhe opsioni për rishikim të ligjit ekzistues për Pyjet dhe shërbimin pyjor, e cila lind edhe si nevojë për të përcaktuar qartë institucionet përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin e fondit pyjor, si dhe për të arritur në vijim, përafrimin në një masë sa më të madhe të legjislacionit të BE-së për pyjet. Sipas opsionit nr.1 do të duhet rishikimi i plotë i ligjit ekzistues nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin pyjor”. Aktualisht rezulton se deri me sot ky ligj është ndryshuar 7 herë duke e humbur pothuajse plotësisht kontekstin e tij për shkak të reformës territoriale dhe administrative. Një ndryshim tjetër në këtë ligj do të ishte i pamjaftueshëm për të përballuar situatën e re në të cilën gjendet sektori pyjor sot. Gjithashtu do të rriste me tej shkallën e konfuzionit të kuadrit ligjor bazë për pyjet.
- Opsioni 2: ligj i ri për Pyjet. Përkatesisht është rekomanduar opsioni për hartimin e kësaj politike pasi konsiderohet si rruga më e mirë dhe më efektive për një menaxhim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të sektorit pyjor, përfarimin e legjislacionit pyjor kombëtar me atë të BE-së, rritjen e efektivitetit në administrimin dhe menaxhimin e pyjeve, rritjen e përfitimeve që vijnë prej fondit pyjor kombëtar si dhe zhdukjen e informalitetit që ekziston aktualisht në një nivel mjaft të lartë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Në rast se nuk kryejmë ndërhyrjet e duhura ligjore, për efekt të këtij vlerësimi të ndikimit të impaktit, ne supozojmë se fondi pyjor dhe kullosor në Republikën e Shqipërisë nuk do të menaxhohet si duhet, nuk do të ketë një sistem cilësor të monitorimit, si dhe nuk do të merren masat e duhura për ruajtjen dhe shtimin e fondit pyjor publik, produktet pyjore dhe jo-pyjore nuk do mund të eksportoheshin në tregun e BE-se por as nuk do mund të importoheshin prej atij tregu.

Opsioni 2, i propozuar për hartimin e ligjit të ri prek grupet e mëposhtme:

- Bashkitë,
- AKP
- Bizneset që merren me produktet dhe nenproduktet pyjore
- Bizneset që merren me aktivitetet rekreative dhe turistike
- AKZM
- AKM,
- Komunitetet.
- OJF-te

Ndikimet konsistojnë në ndarjen/percaktimin e përgjegjësiave konkrete dhe luajtjen e rolit nga secili prej tyre në mënyrë të mirë përcaktuar.

Opsioni i përzgjedhur nuk ka ndikime të drejtpërdrejta mbi konkurrencën.

Ndikimet ekonomike

- Ky propozim do të sjellë rritje të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit

- Kostot në buxhetin e shtetit do të përfshijnë:
 - Kosto për përmirësimin e sistemit të monitorimit të fondit pyjor kombëtar
 - Rritje e stafit ekzistues në MTM dhe institucionet e varësisë, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore;
- Kostot e vazhdueshme që lidhen me:
 - Mbarëvajtjen e sistemit të monitorimit të fondit pyjor kombëtar
 - Financime për rigjenerimin e pyjeve dhe përmirësimin e bilancit të fondit pyjor kombëtar
 - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të përfuara të fondit pyjor kombëtar
 - Kryerjen e vizitave në terren nga stafet pyjore të bashkive, AKP, AKMZ-se dhe degët rajonale,
- Kostot operacionale të monitorimit të fondit pyjor kombëtar, si dhe inspektimet në terren nuk mund të përcaktohen tani, pasi do të përcaktohen në akte nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji.
- Për shkak të përmirësimit të qeverisjes së fondit pyjor publik, do të rriten dukshëm të ardhurat në buxhetet respektive të bashkive

Ndikimet mjedisore

Ndikimet kryesore dhe të drejtperdrejta në mjedis konsistojnë në;

- Rritjen e sipërfaqes së fondit pyjor në Republikën e Shqipërisë dhe përmirësimi i cilësisë së habitateve natyrore do të sjellë rrjedhimisht ndikim pozitiv në mjedis.
- Përmirësimin në menaxhimin dhe administrimin e pyjeve, duke ofruar me shumë shërbime në ekosistemet natyrore të vendit
- Shtimin e vlerës së pyjeve, përmes përdorimit të fondit pyjor në drejtim të zhvillimit të eko-turizmit me shumë se sa përdorimin direkt të përfitimeve që vijnë nga shfrytësimi i pyjeve
- Përmirësim në shërbimet direkte që ofrojnë pyjet të tilla si; mbrojtje nga erozioni, mbrojtje nga rreshqitjet, përmytjet etj. duke sjellë një përmirësim të situatës së përgjithshme mjedisore në shkallë kombëtare
- Rritje të kapaciteteve përthithëse të gazeve të forta, duke përmirësuar kështu bilancin kombëtar të klirimit të gazeve të forta në atmosferë
- Mbrojtjen e cilësisë së burimeve ujore
- Shtimin e jetgjatësisë së hidrocentraleve dhe rezervuareve etj.

Ndikimet sociale:

- Shtimi i bizneseve të eko-turizmit (biznese miqësore ndaj mjedisit)
- Shtim i vizitorëve në zonat e mbrojtura dhe zonat me vlera të larta natyrore.
- Mbrojtje e qendrave të banuara nga erozioni dhe rreshqitjet
- Mbrojtje e veprave të infrastrukurës (rruge, kanalizime, linja elektrike, ujsjellës etj) nga efektet erozive, rreshqitjet, ererrat etj.
- Mbrojtje e tokave bujqësore
- Shti i investimeve në zonat rurale

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës në bashkëpunim me konsulentet kombëtare dhe ekspertin ndërkombëtar u kryen duke analizuar situatën ekzistuese ligjore

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Kriteret që tregojnë arritjen e objektivit nëpërmjet ligjit të ri të pyjeve në Shqipëri:

- **Ndikimet ekonomike** - Ky propozim do të sjellë rritje të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit
- **Ndikimet mjedisore**
 1. Rritjen e sipërfaqes së fondit pyjor në Republikën e Shqipërisë dhe përmirësimi i cilësisë së habitateve natyrore do të sjellë rrjedhimisht ndikim pozitiv në mjedis;
 2. Shtimin e vlerës së pyjeve, përmes përdorimit të fondit pyjor në drejtim të zhvillimit të eko-turizmit me shume se sa përdorimin direkt të perfitimeve që vijnë nga shfrytësimi i pyjeve
- **Ndikimet sociale nëpërmjet:**
 1. Shtimit të bizneseve të eko-turizmit (biznese miqësore ndaj mjedisit)
 2. Shtimit të vizitorëve në zonat e mbrojtura dhe zonat me vlera të larta natyrore
 3. Shti i investimeve në zonat rurale

Matrica e performances

Kriteret	Pesha	Opsioni 0 (nuk do të ketë ndryshim /politike të re)	Opsioni 2 hartimi i një ligji të ri	Opsioni 1 (Hartimi i aktit ligjor për ndryshimin e ligjit ekzistues)
Ndikimet ekonomike - Ky propozim do të sjellë rritje të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit	5	1 (5)	4 (20)	2 (10)
Ndikimet mjedisore Rritjen e sipërfaqes së fondit pyjor në Republikën e Shqipërisë dhe përmirësimi i cilësisë së habitateve natyrore do të sjellë rrjedhimisht ndikim pozitiv në mjedis; Shtimin e vlerës së pyjeve, përmes përdorimit të fondit pyjor në drejtim të zhvillimit të eko-turizmit me shume se sa përdorimin direkt të perfitimeve që vijnë nga shfrytësimi i pyjeve	3	1 (3)	3 (9)	2 (6)

Ndikimet sociale nëpërmjet: Shtimit të bizneseve të eko-turizmit (biznese miqësore ndaj mjedisit) Shtimit të vizitorëve në zonat e mbrojtura dhe zonat me vlera të larta natyrore Shtimin e investimeve në zonat rurale	3	1 (3)	2 (6)	1 (3)
Aftësia për të përmirësuar qasjen në mirëmenaxhimin, financimin e veprimeve, kontrollin dhe monitorimin e fondit pyjor.	4	1 (4)	3 (12)	1 (4)
Kostot	3	3 (9)	1 (3)	2 (6)
Piket		24	50	29

Opsioni i preferuar është hartimi dhe miratimi i projektligjit “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. nr. 10448, date 14.7. 2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar” pasi bazuar ne analizen e dispozitave dhe neneve qe ndryshohen/shtohen u arrit ne perfundimin se nuk eshte e nevojshme te hartohet nje ligji i ri, pasanalizes se bere te vleresimit te mangesive ligjore, nepermjet te cilit u identifikuan nderhyrjet qe duheshin bere. Me reflektimin e tyre ne ligjin ekzistues te vitit 2011 u pa qe ndryshimet e bera nuk perbenin me shume se 50% te dispozitave te ligjit, keshtu qe u konkludua qe opsioni qe do te zgjidhej ishte rishikimi i ligjit dhe jo hartimi i nje ligji te ri.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, së bashku me institucionet e saj të varësisë, është njësia përgjegjëse për monitorimin e zbatueshmërisë së tij, pas miratimit të këtij propozimi.

Pengesat e mundshme mund të hasen gjatë ndarjes së përgjegjësive të institucioneve, si dhe në përcaktimin e sistemit të monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor, kryesisht në zbatimin e këtij sistemi monitorimi.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar për të arritur qëllimet e politikës, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- a) Përmirësim ne qeverisjen dhe menaxhimin e fondit pyjor kombetar
- b) Ruajtja ose restaurimi në gjendjen e favorshme të habitateve natyrore dhe pyjore
- c) Vlerësimi i gjendjes së fondit pyjor dhe monitorimi i vazhdueshëm i kësaj gjendjeje;
- d) Shtimi i permbushjes se funksioneve te pyllit ne drejtim te aktivitetetve qe lidhen me eko-turizmin.
- e) Sigurimi i një kuadri për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të ardhshme, pa degradimin e habitateve dhe shqetësime ndaj llojeve që të ndikojnë në statusin e tyre të favorshëm të ruajtjes;
- f) Kontribuiimi në konservimin e gjendjes natyrore të tokës, në konservimin e cilësisë, sasisë dhe disponueshmërisë së ujit, mirëmbajtjen e atmosferës, prodhimin e oksigjenit dhe kapjen e gazeve serre, si dhe mirëmbajtjen e klimës;

- g) Rritje e dukshme e shërbimeve në ekosistemet natyrore që ofrojnë pyjet (mbrojtje për qendra të banuara, toka bujqësore, infrastrukture etj).

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Projektligji përmban dispozita të dedikuara në nene specifike për përcaktimin e organeve përgjegjëse për menaxhimin, ruajtjen dhe monitorimin e fondit pyjor dhe kullosor në vend, përmes ndarjes së qartë të përgjegjësisë midis organeve/institucione qendrore e vendore dhe shëmbëngjies së mbivendosjes.

Treguesit për matjen e qëllimeve konsistojnë në menaxhimin, ruajtjen dhe monitorimin e fondit pyjor, monitorimin e bilancit të fondit pyjor kombëtar dhe hartimin e raporteve periodike vjetore për gjendjen dhe trendin e fondit pyjor si dhe vlerësimin e statusit të zhvillimit të sektorit pyjor në vend.

Treguesit për të matur arritjen e qëllimeve të politikës për mbrojtjen e fondit pyjor janë si më poshtë:

- Reduktimi i bilancit negativ që ka aktualisht fondi pyjor kombëtar
- Zhdukja e informalitetit të lartë që ekziston aktualisht
- Shtim i sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar
- Monitorimi periodik i gjendjes së pyjeve
- Hartimi i planeve të mbareshtimit të pyjeve
- Shtimi i aktiviteteve ekonomike në fondin pyjor kombëtar, kryesisht bizneseve që merren me eko-turizmin dhe rekreacionin në natyrë
- Rritja e efektit të shërbimeve në ekosisteme që ofrojnë pyjet, duke rritur vlerat e pronave, duke siguruar mbrojtjen nga erozioni, rreshqitjet dhe permbytjet etj.
- Shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore në vend

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

OPSIONI 1:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1	0,9528	0,9079	0,865073	0,82427	0,78539	0,7484	0,71306	0,67942	0,64738
Kosto për buxhetin – njëhere (kosto për stafin e MTM)	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678
Kosto për buxhetin – në vazhdim (kosto për monitorimin e pyjeve nga AKP)	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000

<i>kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki)</i>	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000
<i>Kosto për stafin e Agjensise Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe rajoneve</i>	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678	538.678
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	538678	513271	489063	465995,8	444017	423074	403120	384107	365990	348728
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim(<i>te ardhurave nga hyrja e vizitoreve në Zonat e Mbrojtura</i>)	5.000	5.200	6000	6700	6700	6700	6700	6700	6700	8200
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi nga shitja e lëndës drusore biznesit	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi nga biznesi për dhenie me qera e fondit pyjor	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000
Përfitim për buxhetin – në vazhdim *Përfitim nga tarifa e drureve të zjarrit	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000
Përfitimi në total	215.000	215.200	216.000	216.700	216.700	216.700	216.700	216.700	216.700	218.200
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	215000	205050	196105	187461,3	178620	170195	162168	154519	147231	141258
Vlera aktuale e kostos në total	4.376.044									
Vlera aktuale e përfitimit në total	1.757.606									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-2.618.438									

*Në zërin “*Përfitim për buxhetin në vazhdim*” është planifikuar fond, i cili do të përbëhet nga donatorë, si psh. lidhur me hartimin e planeve të veprimit për mbrojtjen e ruajtjen e faunës së egër, si dhe planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

OPSIONI 2:

Faktori zbritës	1	0,95284	0,90789	0,86507	0,82427	0,78539	0,74835	0,71306	0,67942	0,64738
Kosto për buxhetin – njëhere <i>(kosto per stafin per projektligjin-paga – stafi i MTM)</i>	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678	7.678
Kosto për buxhetin – në vazhdim <i>kosto per monitorimin e pyjeve nga AKP</i>	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000
<i>kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki)</i>	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000	311.000
<i>Kosto per stafin e eAgjensise Kombetrae te Zonave te Mbrojtura dhe rajoneve</i>	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000	180.000
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim (licensimi dhe tregtimi sipas rregulloreve te BE-se FLEGT dhe EUTR)	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim (perdoruesit e druve te zjarrit – tarifa per drute e zjarrit)	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000	420.000
Kosto në total	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678	968.678
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	968678	922990	879457	837977	798453	760794	724911	690721	658142	627101
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim <i>(te ardhurave nga hyrja e vizitoreve ne Zonat e Mbrojtura)</i>	5.000	5.200	6000	6700	6700	6700	6700	6700	6700	8200
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi nga shitja e lendes drusore biznesit	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi nga biznesi per dhenie me qera e	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000	20.000

fondit pyjor										
Përfitim për buxhetin – në vazhdim *Përfitim nga tarifa e drureve te zjarrit	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000	600.000
Përfitimi në total	635.000	635.200	636.000	636.700	636.700	636.700	636.700	636.700	636.700	638.200
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	635000	605241	577421	550792	524813	500060	476475	454002	432589	413157
Vlera aktuale e kostos në total	7.869.224									
Vlera aktuale e përfitimit në total	5.169.550									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-2.699.675									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b
Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	4.376.044	1.757.606	-2.618.438
Opsioni 2	7.869.224	5.169.550	-2.699.675

Pavarësisht se opsioni 1 dhe 2 kanë të njëjtat vlera neto në total kosto/përfitim, është përzgjedhur opsioni 2 (hartimi i nje ligji te ri per pyjet), pasi përzgjedhja e opsionit 1 (ligji ekzsistues) do të sillte vazhdim te degradimit te metejshem te fondit pyjor kombetar.

Shkurtesa	Emërtimi & Përshkrimi
AdZM	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
CNVP	CNVP Foundation Albania (Connecting Natural Values & People)
FKP	Fondi Kombëtar i Pyjeve

FLED	Projekti ““Forest for Local Economic Development”, supported by Sweden (Sida)”
FLEGT	Forest Law Enforcement, Governance and Trade
IPA	Instrumenti i Para-aderimit
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OJF	Organizata jo-fitimprurese
PBA	Projekt-buxheti afatmesem
SIDA	Swedish International Development Agency
TVSH	Tatimi mbi Vleren e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZM	Zonat e Mbrojtura
ZM	Zona te mbrojtura
ZRPP	Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme